VENDIM
Nr. 243, datë 30.3.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 15.12.2015, PËR ÇËSHTJEN "AFËRDITA THEODHOSI KUNDËR SHQIPËRISË" (APLIKIMI NR. 75175/13)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.12.2015, për çështjen "Afërdita Theodhosi kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 75175/13), në shumën 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) euro, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, kostot dhe shpenzimet, duke e përjashtuar nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma, e përcaktuar si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të aplikantes, znj. Afërdita Theodhosi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.12.2015, për çështjen "Afërdita Theodhosi kundër Shqipërisë" (aplikimi nr. 75175/13), bërë përfundimtar në datën 7.1.2016.

4. Pagesa e shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të aplikantes, znj.Afërdita Theodhosi, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor, nga dita kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama